



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 23 qershor 2014  
Nr.Ref.:RK647/14

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin nr. KI163/13**  
**Parashtrues**

Naser Dragusha dhe 6 punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës  
**Vlerësimi kushtetues i Aktgjykimit Rev. nr. 25/2012, të Gjykatës  
Supreme të Republikës së Kosovës, të 10 majit 2013**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Cukalovic, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, Gjyqtar  
Altay Suroy, Gjyqtar  
Almiro Rodrigues, Gjyqtar  
Snezhana Botusharova, Gjyqtare  
Kadri Kryeziu, Gjyqtar dhe  
Arta Rama-Hajrizi, Gjyqtare

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Naser Dragusha, z. Mehmet Shaqiri, z. Bajram Ahmeti, z. Shasivar Hashani, z. Qazim Igrishta, z. Fahri Asllani dhe znj. Selvete Preniqi, të përfaqësuar nga z. Ilaz Çerkinaj, avokat nga Prishtina.

## **Vendimet e kontestuara**

2. Parashtruesit në kërkesën e tyre ankohen ndaj Aktgjykimit Rev. Nr. 25/2012 të Gjykatës Supreme të Kosovës të 10 majit 2013 që atyre iu është dorëzuar më 10 korrik 2013, Aktgjykimit Ac. nr. 270/2009 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të 28 shkurtit 2011 dhe Aktvendimit C. nr. 268/07 të Gjykatës Komunale në Prishtinë të 2 qershorit 2008.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt çështjeje është vlerësimi kushtetues i vendimeve që pretendohet *“se janë të gabuara dhe kundërkushtetuese, sepse parashtruesve iu është mohuar padrejtësisht kompensimi në pagë”*.
4. Në këtë drejtim, parashtruesit pretendojnë shkelje të Nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Nenit 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit], dhe Nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

## **Baza ligjore**

5. Kërkesa bazohet në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), Nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

6. Më 18 tetor 2013, parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 31 tetor 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI163/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI163/13, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
8. Më 14 nëntor 2013, parashtruesit, Gjykata Supreme dhe Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KEK) u njoftuan për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 18 nëntor 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesit që të dorëzojnë dokumente shtesë.
10. Më 19 dhe 20 nëntor 2013, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë në Gjykatë.
11. Më 25 nëntor 2013, Zyra Ligjore e KEK-ut dorëzoi komentet e saj përkitazi me kërkesën e parashtruesve.

12. Më 13 janar 2014, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të dorëzojë dokumente shtesë.
13. Më 20 janar 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë dokumentet shtesë.
14. Më 8 maj 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhje e fakteve**

15. Më 1 tetor 2004, parashtruesit themeluan marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar me KEK-un, me pagë mujore prej 296 € në muaj në vendet e punës *ndihmës manipulues*.
16. Më 2 korrik 2007, parashtruesit paditën KEK-un në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kërkuar ndërrimin e emërtimit të vendit të punës nga *ndihmës manipulues* në *manipulues të kaldajës* si dhe pagesën e dallimit të të ardhurave personale prej 41€ në muaj, për periudhën 1 dhjetor 2004 deri më 1 janar 2007.
17. Më 2 qershor 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktvendimin C. nr. 268/07, përcaktoi:

*REFUZOHET si e paafatshme kërkesëpadia e paditësve Bajram Ahmeti nga Prishtina, lagjeja " Ulpiana ",ndërtesa 13, nr. 1 e Mehmet Shaqiri nga fshati Sveçël, komuna e Podujevës me te cilën kane kërkuar ndërrimin e emërtimit te vendit te punës dhe pagesën e diferencës se te ardhurave personale prej dt. 1.12.2004 deri me dt 01.01.2007 dhe HUDHET si e palejueshme kërkesëpadia e paditësve Fahri Asllani nga fshati Stanovc i Ulët, komuna e Vushtrrisë, Qazim Igrishta nga fshati Stanovc i Ulët, komuna e Vushtrrisë, Shashivar Hashani nga Obiliqi, Latif Preniqi nga Prishtina, lagjeja "Dardania", SU 113, hyrja e III-te, nr. 23 dhe Naser Dragusha nga fshati Prugovc, komuna e Prishtinës, me te cilën kanë kërkuar ndërrimin e emërtimit te vendit te punës dhe pagesën e diferencës se te ardhurave personale prej dt. 1.12.2004 deri me dt 01.01.2007.*

18. Më 4 mars 2010, parashtruesit paraqitën ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
19. Më 28 shkurt 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 270/2009, përcaktoi:

*"REFUZOHEN ankesat e paditësve Bajram Ahmeti nga Prishtina, Mehmet Shaqiri nga fsh. Sveqël, Fahri Asllani dhe Qazim Igrishta nga fsh.Stanovc i Ulët, Shashivar Hashani nga Obiliqi, Latif Preniqi nga Prishtina dhe Naser Dragusha nga fsh. Prugovc si të pabazuar dhe aktvendimi i Gjykatës Komunale ne Prishtine C1.nr.268/2007 i dt. 02.06.2008 VËRTETOHET".*

20. Më 20 maj 2011, parashtruesit paraqitën kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

21. Më 10 maj 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 25/2012, përcaktoi:

*“Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësve paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtine, Ac. nr. 270/2009 datë 28.02.2011, në pjesën që ka të bëjë me ndërrimin e emërtimit të vendit të punës.*

*Ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i gjykatës së shkallës së parë në pjesën që ka të bëjë me kërkesëpadinë e paditësve për pagesën e diferencës së pagave mujore për periudhën kohore nga data 01.02.2004 e deri më 01.01.2007, ashtu që refuzohet në këtë pjesë kërkesëpadia e paditësve si e pabazuar”.*

22. Në aktgjykimin e sipërpërmendur, Gjykata Supreme arsyetoi:

*“...nga shkresat e lëndës del se paditësit të e paditura kanë themeluar kanë themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar prej datës 1.10.2004, në vendet e punës ndihmës manipulues, sipas kontratës së punës nr. 8992/0 datë 1.10.2004 me Naser Dragushën, kontrata nr.1223/0 me Bajram Ahmetin, kontrata nr. 3564/0 me Mehmet Shaqirin, kontrata nr. 8967/0 me Fahri Asllanin, kontrata 12310/0 me Qazim Igrishtën, kontrata nr.2099/0 me Shasivar Hashanin, kontrata nr. 2268/0 me Latif Preniqin, në të cilat kontrata për të gjithë është caktuar paga mujoren shumë prej 296 € dhe të njëjtat janë të nënshkuara nga paditësit dhe e paditura.*

*Paditësit me padinë e ushtruar më 02.07.2007 kanë kërkuar që të detyrohet e paditura që secilit paditës t'i emërtoj vendin e punës “manipulues i kalldajve” siç e kishin edhe më parë dhe secilit veç e veç t'i paguajë ndryshimin e të ardhurave personale nga 41 € për çdo muaj duke filluar prej 01.12.2004 e deri më 01.01.2007 me kamatë ligjore prej ditës së mospagesës e deri në pagesën definitive të gjitha në afat prej (8) tetë ditësh si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.*

*Gjykata e shkallës së parë me administrimin e provave të nevojshme ka vërtetuar se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune të e paditura në bazë të kontratave të punës të datës 1.10.2004 për vendin e punës ndihmës manipulues sipas të cilave kontrata paga mujore është caktuar në lartësi prej 296 €, të cilat kontrata janë nënshkuar nga të gjithë paditësit dhe e paditura, se të njëjtat nuk janë kundërshtuar nga ana e paditësve në kuptim të dispozitave të nenit 83 të Ligjit mbi të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës, dhe ka gjetur se paditësit Mehmet Shaqiri, dhe Bajram Ahmeti, kanë humbur të drejtën në mbrojtje gjyqësore ndërsa paditësit Fahri Asllani, Qazim Igrishta, Shasivar Hashani, Latif Preniqi dhe Naser Dragusha, për shkak se të njëjtit nuk kanë shtjerrë mjetet jashtë gjyqësore për realizimin e të drejtave të tyre duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.*

*Nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se padia e paditësve për ndryshimin e emërtimit të vendit të punës sipas kontratës është e palejueshme, dhe si të tillë e kanë hedhur poshtë ngase kjo çështje nuk është në kompetencë lëndore të gjykatave të rregullta.*

*Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale kur kanë hedhur padinë e paditësve për kompensimin e ndryshimit të pagave mujore në lartësi prej 41 €, për periudhën kohore nga data 01.10.2004 e deri më datë 01.02.2007, në kuptim të nenit 83 paragrafi 1 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga marrëdhënia e Punës, ngase sipas dispozitës së nenit 83 par. 2 të Ligjit të lart cituar është paraparë se: mbrojtja e të drejtave pranë gjykatës kompetente nuk mund të kërkohej nëse paraprakisht nuk ka kërkuar mbrojtje pranë organeve kompetente të organizatës, përveç të drejtave nga kërkesa në të holla, sepse sipas kësaj dispozite të kërkesa për pagimin e kompensimit në të holla që rrjedh nga marrëdhënia e punës nuk zbatohet dispozita e nenit 83 paragrafi 1 të ligjit të lart cituar, prandaj kjo Gjykatë ka ndryshuar aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, në pjesën që ka të bëjë me kërkesëpadinë e paditësve për pagesën e diferencave të papaguara mujore për periudhën kohore prej 01.12.2004, deri më 01.01.2007, duke refuzuar kërkesëpadinë si të pabazuar. Paditësit me të paditurën për periudhën kohore prej 01.12.2004 e deri më 01.01.2007 kanë punuar sipas kontratave të punës të lidhura më 01.10.2004, në kohë të pacaktuar, sipas të cilave kontrata në nenin 2 është caktuar pagesa mujore në lartësi prej 296 €, paditësit për punët e kryera sipas kësaj kontrate kanë realizuar pagat mujore nga e paditura, se nuk kishin kundërshtuar nënshkrimin e kontratave i cili fakt nuk ishte kontestues nga palët ndërgjyqës”*

23. Më 10 korrik 2013, parashtruesit kërkuan nga Gjykata Supreme e Kosovës që të jepte interpretim logjik të paragrafit II të dispozitivit dhe të arsyetimit të Aktgjyimit Rev. nr. 25/2012.
24. Më 4 shtator 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. nr. 25/2012, refuzoi të pabazuar kërkesën e parashtruesve.
25. Në aktvendimin e lartpërmendur, Gjykata Supreme e Kosovës, ndër të tjera, arsyetoi:

*“Gjykata Supreme e Kosovës, pas shikimit të shkresave të lëndës si dhe aktgjykimin e cekur, gjeti se kërkesa e paditësve për përmirësim dhe interpretim të logjikshëm për paragrafin II të dispozitivit të këtij aktgjykimi është e pa bazuar, nga se aktgjykimi në fjalë nuk është i përfshirë me gabime teknike të përshkruara sipas dispozitës së nenit të lartë cituar, dhe se për këtë pjesë gjykata ka dhënë arsye të kuptueshme për marrjen e vendimit në kuptim të dispozitës së nenit 224.1 të LPK”.*

### **Dispozitat relevante**

#### **Ligji Nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore, Neni 224.1**

*“224.1 Në qoftë se gjykata e revizionit konstaton se e drejta materiale është zbatuar gabimisht, me aktgjykim e aprovon revizionin e paraqitur dhe e ndryshon aktgjykimin e goditur”.*

## **Pretendimet e parashtruesve**

26. Parashtruesit pretendojnë “nuk është e qartë se në çfarë aspekti janë ndryshuar aktgjykimet e gjykatave më të ulëta kur revizioni është ushtruar pikërisht për shkak të mos pagesës së diferencës së të ardhurave personale për periudhën e theksuar në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, sepse kjo kërkesë e paditësve ka qenë e refuzuar edhe me aktgjykimet e gjykatave më të ulëta”.
27. Parashtruesit pretendojnë shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

## **Pretendimet e Zyrës Ligjore të KEK-ut**

28. Zyra Ligjore e KEK-ut, ndër të tjera, u shpreh: “KEK Sh. a. pretendon dhe është e bindur se vendimet gjyqësore – aktgjykimet dhe aktvendimet nga Gjykata Komunale, ajo e Qarkut dhe Gjykatës Supreme të Kosovës janë të drejta, të ligjshme dhe meritore, andaj nisur nga ky parim, propozon që kërkesa të hedhet poshtë si e papranueshme”.

## **Vlerësimi i pranueshmërisë**

29. Gjykata vëren që, në mënyrë që të jetë në gjendje të vlerësojë kërkesën e parashtruesve, së pari është e nevojshme të vlerësohet nëse ata i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
30. Përkitazi me kërkesën e parashtruesve, Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

31. Gjykata, po ashtu, i referohet Nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të llogaritet në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të llogaritet që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.*

32. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesit janë palë të autorizuara, kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me Nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit ligjor prej katër muajsh të përcaktuar me Nenin 49 të Ligjit.
33. Gjykata, po ashtu, merr parasysh rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, që përcakton:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

...  
c) kërkesa është qartazi e bazuar”

34. Përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e Kosovës qartë e ka shpjeguar raportin ndërmjet parashtruesve si punëtorë dhe KEK-ut si punëdhënës, bazuar në kontratën e themeluar me pëlqimin e dy palëve si dhe të drejtat dhe detyrimet që dalin nga kontrata e tillë; dhe për më tepër, Gjykata Supreme e Kosovës po ashtu ka dhënë vlerësim të qartë të vendimeve të gjykatave të instancës më të ulët.
35. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih rastin Akdivar kundër Turqisë, Nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65 dhe po ashtu shih rastin KI-86/11, parashtrues i kërkesës Milaim Berisha, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
36. Përveç kësaj, kërkesa nuk arrin të dëshmojë që gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t’i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
37. Fakti që parashtruesit nuk pajtohen me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit], të Kushtetutës (Shih rastin Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
38. Në këto rrethana, parashtruesit nuk i kanë mbështetur me prova pretendimet e tyre për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ata nuk tregojnë në asnjë mënyrë që gjykatat e rregullta ua kanë mohuar atyre të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
39. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në përputhje me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 8 maj 2014, njëzëri

### VENDOSI

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Gjyqtar raportues**



Altay Suroy



**Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani